UDHËZIM
Nr. 634, datë 6.11.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME NR. 224, DATË 11.4.2017, "PËR RREGULLAT PËR KRYERJEN E INSPEKTIMEVE NGA POLICIA E SHTETIT, PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË MASAVE SHTESË TË SIGURISË PUBLIKE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Punëve të Brendshme nr. 224, datë 11.4.2017, "Për rregullat për kryerjen e inspektimeve nga Policia e Shtetit, për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë publike", të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 4 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Germa "a", të ndryshohet si më poshtë:

"a) Funksionimin e sistemit të kamerave të sigurisë, sipas përcaktimeve të germës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike";".

b) Germa "b" të ndryshohet si më poshtë:

"b) Funksionimin e pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë, veçorive fizike të objektit dhe/ose ambientit ku kryhet veprimtaria, si dhe llojit të aktivitetit;".

c) Germa "e" të hiqet.

2. Pas pikës 6, të shtohet pika 6.1, me këtë përmbajtje:

"6.1 Grupi i inspektimit, për shkeljet e parashikuara në pikat 1 dhe 4, të nenit 16, të ligjit nr. 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike", mban procesverbalin përkatës të konstatimit të kundërvajtjes administrative, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit, ndërsa kopja tjetër i dërgohet drejtorit të Drejtorisë vendore të policisë për shqyrtim. Në përfundim të shqyrtimit, ai merr vendim, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.".

3. Pikat 7 dhe 8 të hiqen.

4. Në pikën 9, pas fjalës "Drejtoria", të shtohet fjala "e Përgjithshme".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj

Lidhja nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË _____
KOMISARIATI I POLICISË_____

PROCESVERBAL

PËR
KONSTATIMIN E KUNDËRVAJTJES ADMINISTRATIVE

Në datë _____, Grupi i Inspektimit, i Komisariatit të Policisë _____, i përbërë nga:
1. _____, Përgjegjës,
2._____, Anëtar,
3._____, Anëtar,
në zbatim të Planit të Inspektimit nr._____, datë _____,
_____, ndaj subjektit_____,
_____, me nr. Nipti _____, dhe administrator z/zj. _____,
përpilon këtë procesverbal mbi kundërvajtjen administrative të konstatuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se subjekti i mësipërm ka shkelur pikën ___, të nenit 16 "Sanksionet dhe e drejta e ankimit", të ligjit nr.19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike". Konkretisht:
_____
_____
_____
_____
_____

Sqarime të kundërvajtësit:
_____
_____
_____

Procesverbali hartohet në dy kopje, nga të cilat një i dorëzohet kundërvajtësit dhe një dorëzohet në strukturën vendore të policisë, për shqyrtim të mëtejshëm.

Nënshkrimi i kundërvajtësit
(_____)
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Grupi i Inspektimit
1._____, Përgjegjës
2._____, Anëtar
3._____, Anëtar

Lidhja nr. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË _____

V E N D I M

Nr. _____, datë _____.____.____

Sot në datë __.__._____, pasi shqyrtova procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative nr.____. datë ____.____._____ të mbajtur nga grupi i inspektimit i Komisariatit të Policisë _____, ndaj subjektit _____, me nr. Nipti _____, me administrator z/zj. _____, me adresë: _____,

mbështetur në:

a. ligjin nr.19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike",
b. ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".
c. ligjin nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

Konstatova se:

_____
_____
_____

Në vlerësim të konstatimeve,

V E N D O S A:

_____
_____
_____

Kundër këtij vendimi, subjekti mund të bëjë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

D R E J T O R I

(_____)

Mora dijeni për vendimin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë _____, për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, sot në datën ____.____.____.

Nënshkrimi i kundërvajtësit
(_____)
(Emër, Mbiemër, Firmë)